

Sfidat e arsimit parauniversitar në zonat rurale periferike të Shqipërisë

Prof. Asoc. Gerda Sula,
Eksperte e arsimit parauniversitar

Ky dokument është hartuar në mbështetje të një cikli të dëgjësave publike me anëtarëve të komisioneve parlamentare në kuadër të projektit "Rritja e përgjegjshmërisë së parlamentit ndaj shqetësimeve të qytetarëve", zbatuar nga IDM, Instituti Shqiptar i Shkencës (AIS) dhe Citizens Channel, me mbështetjen financiare të Qeverisë Britanike. Pikëpamjet dhe opinionet e shprehura në këtë dokument janë vetëm ato të autorëve dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet dhe opinionet e qeverisë britanike.

HYRJE

Arsimi është një drejtim kyç për zhvillimin shoqëror dhe ekonomik të një vendi. Megjithatë, në zonat rurale periferike të Shqipërisë, arsimi parauniversitar përballon sfida të mëdha që lidhen me cilësinë e mësimdhënies, infrastrukturën shkollore dhe arritjet e nxënësve. Ky dokument analizon problematikat kryesore dhe ofron rekomandime për përmirësim.

PROBLEMATIKA

CILËSIA E MËSIMDHËNIES DHE ARRITJET E NXËNËSVE

Testi i PISA tregon rënien e nivelit të arritjeve në lexim, matematikë dhe shkencë në Shqipëri, me rënie të theksuar në zonat rurale. Nxënësit shqiptarë renditen nën nivelin mesatar ndërkombëtar në këto teste. Shqipëria ka shënuar rënien më të madhe në botë, sipas rezultateve të testit PISA 2022¹ që monitoron performancën e nxënësve në nivel parauniversitar, në krahasim me rezultatet e PISA 2018. Sipas testit Shqipëria ka humbur plot 47 pikë në lexim, 41 pikë në shkencë dhe 69 pikë në matematikë në krahasim me rezultatet e vitit 2018, duke shënuar përkeqësimet më të mëdha në krahasim me të gjitha vendet e marra në konsideratë në nivel global. Nxënësit shqiptarë janë poshtë nivelit mesatar të vendeve anëtare të Organizatës për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik.² *Nuk kemi të dhëna të disagreguara për shkollat më pak të zhvilluara apo periferike, por besoj se rezultatet e këtyre nxënësve janë ndjeshëm më të ulëta.*

Sipas këtij studimit ndërkombëtar të arsimit, që vlerëson kompetencat e nxënësve 15-vjeçarë në lexim, matematikë dhe shkencë, rezulton se rënien më të madhe Shqipëria e ka pasur në matematikë, ku ka humbur plot 69 pikë, duke shënuar rënien më të madhe në të gjithë globin. Edhe sa i përket leximit, Shqipëria renditet sërish ndër vendet e fundit në nivel global, si Republika Domenikane, Autoriteti Palestinez dhe Filipinet. Në këtë fushë, Shqipëria ka humbur 47 pikë, duke shënuar sërish rënien më të madhe në botë. Edhe në shkencë, Shqipëria është ndër vendet e fundit, njësoj si Jordania apo El Salvadori dhe Guatemala, duke humbur 41 pikë në këtë drejtim. Rezultatet e studimit janë një konfirmim i asaj që është paralajmëruar më herët. Pandemia ndodhi globalisht, por rëniet e Shqipërisë ishin më të mëdha në krahasim me të gjitha vendet e tjera. Këtu nuk ndikon vetëm pandemia, por ka një sërë faktorësh. Gjatë kësaj periudhe vlen për t'u përmendur për shembull mungesa e infrastrukturës për mësimin online.

1 Student performance (PISA 2022) <https://gpseducation.oecd.org/CountryProfile?primaryCountry=ALB&tresh-old=10&topic=PI>

2 Reviews of Evaluation and Assessment in Education: Albania <https://www.oecd-ilibrary.org/sites/7f73878b-en/index.html?itemId=/content/component/7f73878b-en>

KLASAT KOLEKTIVE

Prania e klasave kolektive është një problem i vërtetë në zonat rurale, duke sjellë sfida të mëdha për mësimdhënien dhe nxënësit. Këto klasa shpesh kanë mësues të pakualifikuar dhe mungesë të burimeve të nevojshme për një mësim efektiv.

Në shtator të vitit 2018, Ministria e Arsimit nisi një fushatë të gjerë për të mbyllur një pjesë të shkollave kolektive në disa zona të vendit, të cilat paraqisnin sfida në procesin e mësimdhënies dhe nxënies. *Kjo veprimtari u mor për shkak të performancës së dobët të nxënësve në testet e maturës, veçanërisht në qytetet e Beratit, Matit, Kukësit dhe Gramshit.* Në këtë kohë, Ministria e Arsimit premtoi se në shtatorin e vitit 2019 do të mbylleshin edhe klasat kolektive e shkollave të tjera që kishin shkaktuar sfida në sistemin arsimor.

Banorët e këtyre zonave po përballen me sfida në transportimin e fëmijëve drejt shkollave qendrore, ku po mbahet mësimi. Pagesa e transportit për fëmijët që preken nga mbyllja e klasave kolektive duhet të paguhej nga Zyra Arsimore në bashkëpunim me bashkitë, por kjo nuk u realizua, duke sjellë vështirësi financiare edhe më të mëdha për prindërit dhe duke i detyruar ata të mendojnë për mundësinë e braktisjes së shkollës nga fëmijët e tyre në këto kushte.

Edhe pse procesi për mbylljen e klasave kolektive u përball me kundërshti nga opozita, prindërit dhe mësuesit, në shtatorin e vitit 2018, rreth 348 klasa kolektive u mbyllën në të gjithë vendin dhe mbi 10% e nxënësve u transferuan në shkolla të qendrës. Numri i nxënësve në klasat kolektive vazhdon të jetë i konsiderueshëm. Gati 9% e nxënësve në nivel vendi, veçanërisht në zonat e thella, vazhdojnë të mësojnë në klasa kolektive në vitin shkollor 2019-2020. *Përqindja e nxënësve që vijojnë mësimin në klasat të bashkuara kolektive është më e madhe në Qarkun e Kukësit (24.64%) dhe të Gjirokastrës (19.26%).* Prindërit janë në dilemë se të pranojnë këtë situatë duke rrezikuar cilësinë e arsimit të fëmijëve të tyre, apo të ndërmarrin masa për të transferuar fëmijët në shkolla të tjera, duke e bërë këtë proces shumë të vështirë për ta.

Në strategjinë kombëtare të arsimit parauniversitar, në zërin për reduktimin e klasave kolektive, buxheti nuk është i përcaktuar. Pa një buxhet të mirëmenduar, është e vështirë të presim përmirësim të gjendjes.

RRITJA E BRAKTISJES SË SHKOLLËS

Zonat rurale përballen me regjistrime të pakta në arsimin bazë, duke kontribuar në rënien e numrit të diplomuarve. Faktorë si mungesa e shkollave, mungesa e financimit dhe migracioni kanë ndikuar në këtë problem. Një pjesë e mirë e nxënësve në këto zona vazhdojnë të lënë shkollën apo edhe ta mbarojnë atë pa zotëruar kompetencat bazë. Barazia është gjithashtu një shqetësim, me pabarazitë e vazhdueshme në mundësitë dhe rezultatet arsimore për shkak të rajonit gjeografik të largët apo të izoluar. Kjo kufizon shanset për punësim dhe jetë të shumë të rinjve dhe rrezikon të pengojë zhvillimin kombëtar.

Krijimi i sistemit për parandalim dhe reagim ndaj mosregjistrimit në shkollë dhe braktisjes së arsimit fillor, të mesëm të ulët dhe të lartë është një nga objektivat e Strategjisë kombëtare të arsimit 2021-2026³, por buxheti për këtë objektiv pritet të vijë vetëm nga donatorët e huaj dhe asnjë përqindje e buxhetit të shtetit nuk është fokusuar në këtë objektiv.

3 <https://arsimi.gov.al/wp-content/uploads/2021/05/Draft-Strategjia-per-Arsimin-2021-2026-1.pdf>

REKOMANDIME

NEVOJA PËR RITJE TË BUXHETIT TË ARSIMIT

Është e nevojshme të rritet pjesa e buxhetit të dedikuar për arsimin në nivelet qendrore dhe lokale për të siguruar infrastrukturë të përshtatshme shkollore dhe trajnimin e mësuesve. Shpenzimet për fëmijë në arsim janë në rritje, pjesërisht e mbështetur nga ndryshimet demografike në strukturën e popullatës. Edhe pse në vitin 2020, janë shpenzuar afërsisht 900 USD për fëmijë, krahasuar me rreth 750 USD në vitin 2018, kjo shifër është ende dukshëm më e ulët se mesatarja 9,400 USD (2019) e vendeve të OECD.

Shpenzimet për arsimin si pjesë e PBB-së në Shqipëri janë ende nën pragun e vendeve anëtare të Bashkimit Evropian, me 4.6% të PBB-së së BE-27 (2018). Përpos kësaj, pagat për mësuesit zinin 82% e shpenzimeve për arsim në vitin 2018. Gjithashtu, pesha e arsimit fillor në totalin e shpenzimeve për arsim ra nga 58.2% (2018) në 55.4 % (2020). Arsimi parashkollor është transferuar në nivel të qeverisjes vendore dhe financohet nga fondet e veta si dhe nga transfertat e kushtëzuara nga pushteti qendror. Kategoritë e fëmijëve në nevojë përfitojnë tekste falas, bursa, transport, mësues të përkushtuar dhe masa të tjera që përbënin 7.1 për qind të buxhetit të këtij programi në vitin 2019, i cili është në një trend në rritje gjatë viteve të fundit.

ZHVILLIMI I POLITIKAVE TË SPECIALIZUARA


Qeveria duhet të zhvillojë politika specifike për të adresuar sfidat e arsimit në zonat rurale, duke përfshirë investime në trajnimin e mësuesve, infrastrukturën shkollore dhe promovimin e arsimit të detyruar. Në këtë situatë, sugjerohet *gjetja e alternativave për mësimin në klasa kolektive, duke përdorur metodologji të përshtatshme*. Megjithatë, për të realizuar këtë, nevojiten mësues të përgatitur mirë dhe kushte të mira shkollimi. Ndërkohë, mungesa e infrastrukturës dhe transportit të rregullt bën që prindërit të jenë të vështirësuar për të siguruar ardhjen dhe kthimin e fëmijëve në shkollë.

Në përfundim, reforma në klasat kolektive duhet të gjejë një balancë që mundëson përfundimin e arsimit të detyruar për nxënësit, duke u kujdesur që të sigurojë cilësinë e arsimit. Megjithatë, duhet të merren parasysh edhe nevojat dhe kushtet e prindërve dhe nxënësve në këto zona periferike për të garantuar një sistem arsimor që i shërben të gjithëve.

PROMOVIMI I ARSIMIT ALTERNATIV

Gjetja e formave alternative të mësimin, si mësimi në klasa kolektive, duhet të shoqërohet me përmirësimin e kushteve dhe trajnimin e mësuesve për të siguruar një mësim efektiv.

Në përfundim, për të adresuar sfidat e arsimit parauniversitar në zonat rurale periferike të Shqipërisë, është e nevojshme një përpjekje e përbashkët nga qeveria, shoqëria civile dhe komuniteti për të siguruar qasje të barabartë në arsim dhe për të përmirësuar cilësinë e mësimdhënies. Investimet në infrastrukturë shkollore, trajnimin e mësuesve dhe promovimin e arsimit të detyruar janë hapat kryesorë drejt një sistemi arsimor më të efektshëm në zonat rurale të vendit.



Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim — IDM është një organizatë jo-qeveritare, e themeluar në nëntor të vitit 1999, që ka në fokus të veprimtarisë së vet qeverisjen pjesëmarrëse dhe institucionet demokratike, procesin e integritimit në Bashkimin Evropian, zhvillimin e shoqërisë civile, bashkëpunimin rajonal dhe çështjet e sigurisë. Ne synojmë konsolidimin e zhvillimeve në këto fusha nëpërmjet hulumtimit të pavarur, rritjes së kapaciteteve dhe ndërveprimeve efikase përmes spektrit të gjerë të aktorëve në shoqëri.

Institute for Democracy and Mediation
Rr. Shenasi Dishnica, Nd.35, H.1, 1017
T: +355 4 240 0241 | C: +355 67 38 42 437
www.idmalbania.org